



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

**KUVENDI**

*Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik*

**PROCESVERBAL**

Tiranë, më 17.06.2021, ora 09:30

**Drejton mbledhjen:**

**Ramazan Gjuzi - kryetar i Komisionit**

**Rendi i ditës:**

1. Miratimi i procesverbaleve të datave 28 maj dhe 1 qershor 2021.
2. Diskutimi i kërkesës së Këshillit Drejtues të RTSH-së për rritjen e masës së shpërblimit mujor të anëtarëve të këtij Këshilli.

**Marrin pjesë:**

Ramazan Gjuzi, Mirela Kumbaro, Vilma Bello, Musa Ulqini, Fadil Nasufi, Ismet Beqiraj, Adelina Rista, Bujar Çela, Almira Xhembulla, Lindita Nikolla, Erion Piciri, Selami Jenishehri, Kostaq Papa, Amra Barova.

**Mungojnë:**

Fidel Ylli, Klajdi Qama, Fatjona Dhimitri dhe Enada Kapllani.

## HAPET MBLEDHJA

**Ramazan Gjuzi** – Mirëmëngjesi!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik.

Në rendin e ditës kemi dy pika. Pika e parë është miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të komisionit të datave 28 maj dhe 1 qershor 2021, kurse pika e dytë është diskutimi i kërkesës së Këshillit Drejtues të RTSH-së për rritjen e masës së shpërblimit mujor të anëtarëve të këtij Këshilli.

Para se të fillojmë me diskutimet, verifikojmë kuorumin.

Zonja Kumbaro është prezente.

Zoti Ylli?

Zoti Ulqini?

**Musa Ulqini** – Prezent.

**Ramazan Gjuzi** – Zonja Bello?

Zoti Beqiraj?

**Ismet Beqiraj** – Prezent.

**Ramazan Gjuzi** – Zoti Nasufi? Prezent.

Zonja Rista?

**Adelina Rista** – Prezent.

Zoti Çela?

**Bujar Çela** – Prezent.

**Ramazan Gjuzi** – Zonja Xhembulla?

**Almira Xhembulla** – Prezente.

**Ramazan Gjuzi** – Zonja Nikolla?

**Lindita Nikolla** – Prezente.

**Ramazan Gjuzi** – Zonja Kapllani?

Zoti Qama?

Zonja Dhimitri?

Zoti Jenishehri?

**Selami Jenishehri** – Prezent.

**Ramazan Gjuzi** – Zoti Papa.

**Kostaq Papa** – Prezent.

**Ramazan Gjuzi** – Zonja Barova?

**Amra Barova** – Prezente.

**Ramazan Gjuzi** – Zoti Piciri?

**Erion Piciri** – Prezent.

**Ramazan Gjuzi** - Kuorumi i nevojshëm për zhvillimin e mbledhjes është i pranishëm.

Fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës. Kush është dakord me procesverbalin e mbledhjes së datës 28 maj 2021? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kush është dakord me procesverbalin e mbledhjes së datës 1 qershor 2021? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Vazhdojmë me pikën e dytë të rendit të ditës, diskutimin e kërkesës së Këshillit Drejtues të RTSH-së për rritjen e masës së shpërblimit mujor të anëtarëve të këtij Këshilli. Të gjithë anëtarët e komisionit janë njoftuar nga ana e sekretarisë për këtë kërkesë.

Kush e do fjalën?

Po, zonja Kumbaro.

**Mirela Kumbaro** – Faleminderit!

Besoj që kjo mbledhje është më shumë një konsultim midis nesh, sepse në përvojën time, për aq kohë sa jam këtu, kjo është hera e parë që ne marrim një kërkesë për rishqyrtim të tarifave. Ndoshta kjo mund të ketë ndodhur më parë dhe Musai ka eksperiencë më të gjatë në Komisionin e Medias, por për mua kjo është eksperiencë e munguar.

Në memon që na ka ardhur nga Shërbimi i Monitorimit, bëhet krahasimi me anëtarët e bordit të AMA-s, më konkretisht me kryetarin e AMA-s dhe nënkryetarin e AMA-s, të cilët janë me kohë të plotë pune, ndërkohë që në Këshillin Drejtues të Radiotelevizionit Shqiptar, sipas ligjit në fuqi, nuk janë me kohë të plotë pune.

Ka një masë shpërblimi, ku kryetari përfiton një shpërblim 20% më të lartë sesa anëtari, por edhe shpërblimi i anëtarit është i paracaktuar me vendim të këtij komisioni përpara nesh, në masën 46 260 lekë.

Unë mendoj që ky është një Këshill shumë i rëndësishëm. Aq më tepër, kjo kërkesë na vjen pas kompletimit të Këshillit Drejtues të Radiotelevizionit me anëtarësinë e plotë, ku nuk ka më vakanca dhe ku paramendoj që Këshilli mblidhet në mbledhje të rregullta dhe tashmë janë të gjithë bashkë për të diskutuar.

Në kontekstin ku ka një frymë, siç e kam perceptuar unë, nga ky Këshill, për t'i dhënë një frymë të re Radiotelevizionit Shqiptar për t'u përgatitur për hapjen e konkursit, pas përfundimit të mandatit të drejtorit ekzekutiv të Radiotelevizionit, është një volum interesant pune, por edhe një frymë për të futur gjëra të reja pas një 5-vjeçari që shteroi misionin e vet të

parë. Në këtë kontekst, e gjej jo të pajustificuar kërkesën për të rishikuar tarifat, gjithsesi, nga memoja që na ka ardhur, nuk e kam shumë të qartë se si do të procedojmë, sa do të jetë kjo masë, sidomos si jemi krahasuar me këshilla të tjerë drejtues të së njëjtës natyrë. Gjithsesi, unë mendoj që është një gjë për t'u konsideruar, është një shqyrtim që duhet të bëhet nga komisioni.

Në këtë kontekst, ky konsultim mes nesh vlen për të kuptuar se si do të procedojmë, sa do të duhet ta pranojmë, në ç' masë do të duhet ta rrisim, si do të duhet ta llogarisim këtë gjë. Kjo ishte, në fakt, edhe iniciativa e kryesisë së komisionit për të bërë një mbledhje konsultimi mes nesh, në bazë të kërkesës që kemi marrë nga Këshilli dhe pas memos që kemi marrë nga Shërbimi i Monitorimit.

E bëra këtë ndërhyrje të vogël më shumë për të nxitur diskutimin dhe për të shkëmbyer me njëri-tjetrin mendimet tona.

**Ramazan Gjuzi** – Faleminderit, zonja Kumbaro!

Po, zoti Ulqini.

**Musa Ulqini** – Faleminderit, zoti kryetar!

E dëgjova me shumë vëmendje zonjën nënkryetare dhe bie dakord me mënyrën se si ajo e parashtrroi çështjen, sepse në parim askush nuk është kundër që të rriten pagat dhe shpërblimet, absolutisht. Por natyrisht, ne që përfaqësojmë popullin dhe mbrojmë interesat e tij, duhet të bëjmë detyrën, në kuptimin që paratë publike të menaxhohen në përputhje me mundësitë dhe duke pasur parasysh arsye bindëse, argumente ligjore, profesionale, financiare përse duhet ngritur ose duhet ulur një shpërblim, siç është rasti në fjalë.

Në diskutimin që është bërë vite më parë për këtë çështje, nuk është zbatuar parimi që shpërblimi i anëtarëve të Këshillit Drejtues të lidhet me pagën e drejtorit, për të shmangur një konflikt interesi, sepse Këshilli Drejtues, për t'i rritur pagën vetes, mund të rrisë në infinit ose pa logjikë pagën e drejtorit të Përgjithshëm. Kjo ka qenë arsyeja.

E sjell në vëmendjen e anëtarëve të komisionit për të kuptuar pse kjo referencë bëhet me AMA-n dhe jo me drejtorin e Përgjithshëm. Unë mendoj që Këshilli Drejtues e ka për detyrë që, kur sjell një propozim, të sjellë edhe argumente, sepse nuk është argument ajo që thuhet në fund të kërkesës që propozimi për të rritur shpërblimin bëhet për shkak se është një organ i rëndësishëm. Absolutisht që është një organ i rëndësishëm, por duhet të ketë, e përsëris, një studim, një logjikë. Po sjell një shembull: përse këshilltarët bashkiakë me ligj marrin 10% të pagës së kryetarit të bashkisë. Këshilli bashkiak i kryeqytetit është një institucion shumë i rëndësishëm, jo sepse menaxhon 1 milion qytetarë, por sepse është zgjedhur me votën e qytetarëve. Raporti është 1 me 10, ndërkohë që detyrimet e këshillit bashkiak janë të jashtëzakonshme për sa i takon morisë së problemeve që ata shqyrtojnë.

Thënë kjo, nuk po them që të jetë 10% dhe nuk e kam fare në këtë sens, por unë mendoj që Këshilli Drejtues medoemos, në zbatim të kompetencave që ka, duhej të kishte sjellë një studim. Për këtë arsye, edhe sekretari i Përgjithshëm, në parashtresën që ka bërë dhe na e ka sjellë, thotë që edhe komisioni përkatës, domethënë komisioni ynë mund t'i propozojë. Pra, e shikon si mundësi dhe askush nuk është kundër kësaj mundësie.

Së dyti, unë them që, edhe po ta kemi studimin, propozimi ynë duhet të zbatohet patjetër nenin 82, pika 2, të Kushtetutës, të cilën dua ta lexoj: “Asnjë projektligj joqeveritar që bën të nevojshme rritjen e shpenzimeve të buxhetit të shtetit ose pakëson të ardhurat, nuk mund të miratohet pa marrë mendimin e Këshillit të Ministrave, i cili duhet të shprehet brenda 30 ditëve nga data e marrjes së këtij projektligji”.

E solla këtë në vëmendjen tuaj, kolegë anëtarë të komisionit, për të qenë sa më të qartë, që të mos nxitojmë në një vendimmarrje, por ta diskutojmë mbi bazën e asaj çfarë ka ndodhur deri tani, por duke pasur parasysh edhe se çfarë ndodh me bordet e tjera, se nuk është vetëm bordi i RTSH-së, por ka plot borde në Shqipëri.

Prandaj, unë këmbëngul, dhe e them për herë të fundit, që duhet patjetër të kemi një studim, të kemi disa argumente ligjore, argumente financiare dhe të kemi përvojën e institucioneve të tjera se si janë pagat e këshilltarëve, pra raportin e shërbimit të këshilltarëve me kryetarin e bashkisë.

Së treti, dhe këtu kërkoj vëmendjen tuaj, unë mendoj që edhe nga pikëpamja etike, akti i parë i Këshillit të ri Drejtues nuk mund të jetë rritja e shpërblimit për veten, ndërkohë që ky këshill drejtues ka shumë detyra, ka shumë emergjenca dhe ka shumë gjëra, të cilat janë për t'u sjellë këtu, për t'u miratuar përpara kësaj gjëje. Sipas ligjit, akti i parë i Këshillit Drejtues është zgjedhja e nënkryetarit, nënkryetar i cili përfaqëson opozitën. Maxhoranca ka fituar mandatin e tretë dhe unë besoj se kjo mundësi kaq e madhe që i dhanë qytetarët, është një besim edhe në të gjitha aspektet e tjera të kësaj maxhorance, kështu që kur flasim për borde të tilla, duhet që ta respektojmë ligjin, të respektojmë edhe opozitën, se kanë kaluar 40 ditë dhe nuk e ka zgjedhur zëvendësin. Ky është detyrimi i parë, jo ky akt për të rritur shpërblimin e vet, pavarësisht nga masa, sepse ka nevojë për diskutim. E para.

E dyta, është absurde që kanë kaluar 40 ditë, edhe pse ka mbaruar mandati i drejtorit të Përgjithshëm, Këshilli Drejtues nuk e ka hapur vakancën. E kam thënë edhe në një mbledhje tjetër, nuk dua ta theksoj më, se është mbledhja e parafundit. Këto ditë unë kam takuar disa përfaqësues ndërkombëtarë që monitorojnë mediat në Shqipëri, për arsye të vlerësimit që ata kanë për kontributin tim 25-vjeçar në këtë komision, dhe aty kuptova që ata janë shumë të shqetësuar dhe nuk e kuptojnë këtë lloj arsyeje, përse nuk hapet vakanca për drejtorin e

Përgjithshëm të RTSH-së. Janë 40 ditë. Nuk ka asnjë lloj arsyeje. Nuk mund të drejtohet një institucion kaq i rëndësishëm me një drejtues jo të zgjedhur sipas ligjit, por të ngarkuar me këtë detyrë nga Këshilli Drejtues, është absurde! Po ju them edhe një herë, ligji për këtë arsye ka ngarkuar Kryetarin e Këshillit Drejtues që ky, sapo të krijohet vakanca, menjëherë të bëjë mbledhje dhe të hapë vakancën. Pse e ka bërë ligjvënësi një gjë të tillë në ligj, te statuti, neni 15, pika 1? Që të mos vonohet kjo procedurë. Nuk ka asnjë arsye që kur drejtori jep dorëheqjen, kur drejtorit i mbaron mandati, që meqenëse nuk merren vesh anëtarët e komisionit të mos hapet procedura. Prandaj ligjvënësi ia ka caktuar me ligj këtë detyrim ligjor kryetarit edhe pas 40 ditëve, se edhe nja 60 ditë mund të shkojë procedura e përzgjedhjes, kështu që nuk është normale.

Është një lloj voluntarizmi. Nuk dua të bëj asnjë koment tjetër, por është i pakuptueshëm, është në dëm të institucionit. Është një gjë që s'ka pse ta penalizojë në një sektor kaq të ndjeshëm, siç është media publike dhe media në përgjithësi, maxhorancën aktuale. Dua t'ju kujtoj juve, që jeni atje dhe sidomos nënkryetares, se sa të ndjeshëm janë ndërkombëtarët, kur është fjala për ligjin për mediat. Nuk dua të sjell shembuj, por kam parasysh iniciativën që morëm ne, për t'i jetësuar në formën e ndryshimeve ligjore ato që gjëra që thuheshin te vërejtjet e Komisionit të Venecias, te ligji për shpifjen dhe janë shumë projekte të tjera, për të cilat ndërkombëtarët kanë ndërhyrë menjëherë. Pse duhet të penalizojmë maxhorancën dhe të lexohet si një lloj arrogancë mandati i tretë, për një gjë që është ligjore, që e kanë për detyrë?

Edhe nga pikëpamja etike nuk shkon, që akti i parë të jetë rritja e shpërblimit për veten dhe jo kryerja e detyrave, siç është zgjedhja e nënkryetarit, që Këshilli Drejtues të veprojë ashtu siç duhet, me kryetar dhe me nënkryetar, sepse tashmë është kompletuar. Unë e kam për detyrë ta them këtë, për shkak edhe të një përgjegjësie që kam, meqenëse është mbase mbledhje fundit, por edhe në respekt të përvojës edhe asaj çfarë ka ndodhur në këtë komision.

Edhe një herë kërkoj që ky propozim të merret në konsideratë, por mbi bazën e një studimi dhe të respektohen, siç thashë, shumë argumente dhe jo argumente voluntariste, "meqenëse ne mendojmë se jemi të rëndësishëm". Të gjithë janë të rëndësishëm në këtë vend, por ka logjikë, kur është fjala për mënyrën se si caktohen pagat, shpërblimet, se si menaxhohet paraja publike dhe prandaj Kushtetuta, në mënyrë specifike e ka caktuar, e ka ngarkuar me ligj Këshillin e Ministrave si institucionin për menaxhimin e parasë publike, që të shprehet në të gjitha rastet kur vijnë propozime që e rrisin apo e ulin buxhetin e shtetit, nga jashtë Parlamentit, nga grup deputetësh, nga këshilla drejtuese, nga borde apo nga institucione e të tjera.

Besoj se kam qenë shumë korrekt me atë çfarë përcakton rregullorja e Kuvendit, ligji dhe kam një shqetësim të vërtetë. Ma besoni këtë që them, nuk ka asnjë arsye që Shqipëria, kjo

maxhorancë, në ditët e para të penalizohet pa asnjë të drejtë. Nuk ia ka askush, kurrkujt, për borxh që të krijohen shqetësime të tilla, sepse e theksoj, dhe kjo është fjalia ime e fundit: për mediat reagimet janë të menjëhershme, nuk janë si në sektorët e tjerë.

Kaq kisha.

Faleminderit!

**Ramazan Gjuzi**- Zonja Bello, fjala për ju.

**Vilma Bello**- Faleminderit, kryetar!

E kemi lexuar me vëmendjen raportin e shërbimit të monitorimit, ashtu siç dëgjova po aq me vëmendje edhe kolegët e mi, zonjën Kumbaro dhe zotin Ulqini, dhe jam shumë dakord me argumentet që renditën. Personalisht, duke u pajtuar me ato që u diskutuan dhe që u thanë nga kolegët, propozoj që ne, si komision, t'i kërkojmë mendim Ministrisë së Financave për t'u shprehur për këtë situatë dhe, gjithashtu, edhe Komiteti Drejtues i RTSH-së të sjellë një argumentim më të detajuar, se cilat janë arsytet e vërteta të kërkesës së kësaj rritjeje, sepse, nëse argumentimi do të jetë i duhur, rritja mund të jetë më shumë se në masën 30%, por për të përcaktuar rëndësinë e rritjes së masës së këtij shpërblimi, neve na duhet të kërkojmë edhe një mendim në Ministrinë e Financave dhe komisioni të ketë kohën e nevojshme për të qenë më të plotë dhe më të qartë në vendimin që duhet të marrë. Pra, propozimi im është për t'i kërkuar mendim Ministrisë së Financave për këtë situatë dhe një raport më të detajuar nga Komiteti Drejtues i RTSH-së.

Faleminderit!

**Ramazan Gjuzi** - Faleminderit, zonja Bello!

Zoti Piciri, fjala për ju.

**Erion Piciri** - Faleminderit, zoti kryetar!

Unë që në fillim jam kundër këtij shpërblimi shtesë të anëtarëve të Këshillit të Drejtues të RTSH-së. Në kërkesën e tyre shoh që paga është diku te 462 mijë lekë të vjetër, shifër që korrespondon 1,5 herë më e lartë se rroga minimale në Shqipëri dhe shkon deri në 90% të rrogës mesatare, të atyre që punojnë me kohë të plotë. Zoti Ulqini bëri krahasimin me Bashkinë e Tiranës, por unë do të bëj një krahasim tjetër, me rrogën e pedagogëve të universiteteve shtetërore, të cilët paguhen me orë. Ora e punës varion nga 4-12 mijë lekë të vjetër, ku mesatarja është diku te 9 mijë lekë të vjetër, pra, i bie që anëtarët e Këshillit Drejtues të RTSH-së, të paktën nëse barazohen me pedagogët, të investojnë rreth 60 orë në muaj. Nuk e kemi këtë të dhënë se sa herë mbledhet këshilli, por duke pasur parasysh edhe eficiencën e institucionit, ai është një institucion që nuk ka ndonjë rezonancë në shoqërinë shqiptare. Unë kam bërë disa kërkime për të parë se ku qëndron ky institucion me audiencën dhe kjo është një para e çuar

dëm, sepse vetëm rreth 2-3% e publikut informohet dhe ndjek RTSH-në. Në qoftë se ne duam të ndërtojmë vendin e së ardhmes, është pikërisht vlera që ka paraja e qytetarit në buxhetin e shtetit. Ne e shpërdorojmë buxhetin e shtetit në mënyrë të jashtëzakonshme me pagat me nivel më të lartë, që nuk kanë arsye të jenë të tilla. Kjo duke parë edhe eficiencën e institucioneve. I mëshoj idesë që sa u zgjodh kryetari i ri, kërkesa e parë erdhi për rritje pagash.

Bashkohem me kolegen parafolëse, që të na japin edhe një informacion se sa është mesatarja e orëve mujore që këta njerëz mblidhen, në mënyrë që të kemi një ide më të qartë dhe ta barazojmë me pagën e pedagogëve, të cilët janë me tituj dhe janë njerëz që realisht i japin produkt shoqërisë, ose të shkojmë me idenë e asaj që sa marrin njerëzit në këshillin bashkiak të Tiranës, e cila është një bashki e rëndësishme, me vendime të qenësishme, të cilat shkojnë diku te 150 euro në muaj, ndërsa bosëve tanë të Këshillit Drejtues të RTSH-së nuk u dalin 300 euro në muaj. Kështu që jam tërësisht kundër kësaj. Unë jam pro këtij shpërblimi vetëm nëse vjen ndonjë argument që këta njerëz punojnë 100-150 orë në muaj dhe japin një kontribut të jashtëzakonshëm në një institucion, që realisht ia vlen dhe nuk është një institucion i dominuar politikisht dhe i varfër nga pikëpamja e asaj që transmeton te publiku, dhe sa ndiqet nga shoqëria.

Nga të dhënat që unë kam në medie, shoh që ky është një institucion, i cili i çon paratë dëm dhe produkti i tij nuk ndiqet shumë nga qytetarët shqiptarë.

Rritja e pagave dhe ky spekulim i jashtëzakonshëm në sektorin publik është shkatërrimi i një shoqërie. Ne do të ecim përpara, kur sektori publik, jo vetëm këta të Radiotelevizionit, por në tërësinë e tij, rëndon gjithnjë e më pak në ekonominë kombëtare dhe ne i japim një stimul sektorit privat, me të cilin jemi deficitarë. Ne kemi një ndër administratat më të fryra në Europë, me 170 mijë punonjës që, duke përjashtuar bujqësinë, ne arrijmë në 25% të punësimit tërësor. Kjo është një barrë e rëndë mbi ekonominë kombëtare dhe, ndoshta, maxhoranca e re do të nxjerrë mësim për ta çuar Shqipërinë atje ku duhet.

Një fjali të fundit kam me atë, që do të shtyjë pak zoti Ulqini. Zoti Ulqini, prisni opozitën reale. Zgjedhjet u bënë, të vijnë edhe ata njerëz që përfaqësojnë sot rreth 50% të elektoratit dhe zgjidhni organet drejtuese, jo se ka ndonjë rol Radiotelevizioni Shqiptar, sepse lojërat e maxhorancës bëhen përtej Radiotelevizionit shtetëror, por prisni opozitën reale.

**Ramazan Gjuzi** – Faleminderit, zoti Piciri!

Urdhëroni, zonja Kumbaro!

**Mirela Kumbaro** – Faleminderit, zoti kryetar!

Më lejoni që të shpreh, në njëfarë mënyre, paksa, reagimin dhe indinjatën time në lidhje me tonin përçmues që iu bë institucionit më të rëndësishëm të medias publike, që është



Radiotelevizioni Shqiptar. Nuk mund ta pranoj një nënvlerësim të tillë për vetë Radiotelevizionin, i cili është televizioni që mbulon në masën 100% të gjithë territorin. Nuk mund ta pranoj që është pa eficiencë, ndërkohë që në këto vite janë shtuar kanalet paralele të Radiotelevizionit. Nuk mund ta pranoj, kur vullneti jo thjesht i maxhorancës aktuale dhe i forcave politike, por vullneti i të gjithë shoqërisë shqiptare është që, nëse janë bërë 5 gjëra të mira, të vazhdojnë të bëhen 5, 15 dhe 50 në Radiotelevizionin Publik Shqiptar, që, pa dyshim, është një ndër asetet kombëtare më të rëndësishme që ne kemi dhe puna e atyre që kontribuojnë, qoftë në formatin e Këshillit Drejtues të RTSH-së, qoftë në formatin e profesionistëve që punojnë, qoftë në formatin e administratës, të nënvleftësohet dhe të konsiderohet si harxhim dhe shpërdorim parash, aq më pak të matet në mënyrë të thjeshtëzuar dhe tepër të rëndomtë me 2-3 orë pune. Unë besoj se këtu çdo sistem krahasimi i bërë në mënyrë kaq empirike, saç e dëgjova pak më parë, me çfarëdolloj kategorish të tjera profesionale të nderuara po aq, më shumë apo më pak, nuk jemi ne këtu që kemi matësin, etalonin e vlerësimit, sepse çdo punë matet brenda fushës së saj, më duket shumë thjeshtëzues, e para.

Së dyti, nuk është e vërtetë që ky është vendimi i parë ose kërkesa e parë që vjen nga Këshilli Drejtues. Këshilli Drejtues tashmë për 2-3 muaj është në aktivitet. Për shkak të detyrës që unë kam në drejtimin e këtij komisioni, kam informacione që Këshilli Drejtues është mbledhur jo thjesht rregullisht, për aq sa e kërkon ligji, por është mbledhur edhe shumë më tepër dhe shumë më shpesh se sa e kërkon ligji.

Nga ana tjetër, nëse komisioni ka dëshirë që të ketë një informacion më të plotë, më duket e drejtë kërkesa që ta kemi këtë informacion, jemi këtu dhe mund ta kërkojmë sa herë që të vijmë i gjithë Këshilli, kryetari apo një pjesë e tyre. Kjo është krejt në diskrecionin tonë që ta bëjmë dhe të informohemi, por ky komunikim do të mundësonte që të mos paragjykojmë dhe të mos lëshojmë konsiderata për perceptime të pabazuar asgjëkund. Nga ana tjetër, unë nuk jam në gjendje të bëj krahasime midis sistemit të honorarëve ose të shpërblimeve të anëtarëve të këtij Këshilli. Por, nëse ne i kërkojmë këtij Këshilli të jetë efikas, veprues, proaktiv në punën e tij, aq më tepër në përgatitjen e një konkursi që do të sjellë një drejtues në krye të Radiotelevizionit, besoj se kemi të gjitha arsyet që t'ia kërkojmë të jetë efikas. Por kjo nuk do të thotë që ata nuk kanë të drejtën të kërkojnë një shpërblim të arsyeshëm, sepse kjo nuk është thjesht punë vullnetare, sikurse edhe kjo jona nuk është thjesht punë vullnetare; ne kemi ardhur me vullnetin tonë të plotë, por edhe ne marrim një pagesë, të gjithë këto dalin nga paratë e taksapaguesve, dikush shërben si deputet, dikush shërben atje si anëtar i Këshillit Drejtues. Që të ketë një kërkesë për rishikim të shpërblimeve në çfarëdo lloj mase, kjo më duket normale, nëse vjen nga Këshilli apo nga bordi i AMA-s, apo nga Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë

Kulturore, apo nga Këshilli Drejtues i RTSH-së, janë kërkesa krejt normale. Detyra jonë është t'i shqyrtojmë, t'i vlerësojmë brenda kuadrit ligjor dhe jo t'i përçmojmë, duke hyrë në konsiderata, që nuk duket se kanë lidhje me këtë.

Thënë kjo, ajo që konstatoj është se pavarësisht konsideratave apo opinioneve që japim, kemi një paqartësi lidhur me atë që do të ishte një masë e drejtë e vlerësimit të shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Drejtues. Në këtë kuptim, propozimin që bëjnë zoti Ulqini dhe zonja Bello, nuk e gjej të pavend dhe këtu kam dhe një përgjigje të vogël për zotin Ulqini lidhur me ndërkombëtarët. Unë jam dakord me të gjitha konsideratat që kanë të bëjnë me rëndësinë që ka çdo sektor i medias në çdo hap të tij, qoftë në atë që zhvillohet në pushtetin e katërt, qoftë në atë që zhvillohet brenda kuadrit të Kuvendit si ligjvënës, apo korniza ligjore dhe rregullatore, që ne përcaktojmë, por ne këtë e bëjmë sepse besojmë se kemi zgjedhur të jemi një shoqëri demokratike, sepse e kemi parim themelor në Kushtetutë dhe në vetëdijen tonë, po të doni edhe në ndërgjegjen tonë personale, duke filluar nga unë e para dhe nga zoti Ulqini, që vijmë nga bota e medias. Arsyeja e fundit për të cilën ne do ta mbanim këtë qëndrim është jo se e kërkojnë ndërkombëtarët, të cilët janë partnerët tanë, që besojnë në të njëjtat parime si dhe ne, por sepse ne besojmë vetë dhe në këtë biem dakord me partnerët ndërkombëtarë që besojnë në të njëjtat parime, që na çojnë në atë që duam të jemi një vend europian, jo vetëm gjeografikisht, por dhe demokratikisht.

Këtë kisha për të thënë.

**Ramazan Gjuzi** – Ju faleminderit, zonja Kumbaro!

**Erjon Piciri** – Zoti kryetar!

Një minutë t'ia jap fjalën zotit Nasufi, pastaj do të ta jap ty.

Zoti Nasufi.

**Fadil Nasufi** – Faleminderit, zoti kryetar!

*(Nuk dëgjohet)*...që u dha nga kolegët unë mendoj se jemi dakord për çdo rritje honorari, ose page, por tagri për këtë problem nuk është thjesht yni, është yni si rast i shqyrtimit të kërkesës së Këshillit Drejtues të RTSH-së, por është tagër i shprehjes me akte normative të Këshillit të Ministrave, sepse ka referenca që të gjithë anëtarët e bordeve ose të këshillave kanë një përqindje të caktuar ndaj pagës së titullarit dhe në këtë mënyrë ne duhet ta respektojmë këtë parim.

E dyta, ka borde ose këshilla të institucioneve publike, të sh.a.-ve, ka dhe të institucioneve të pavarura. Fjala vjen: bord të *(nuk dëgjohet)*, bord të energjisë, etj, kanë tjetër referencë, kurse institucionet publike, si RTSH-ja janë të lidhura domosdoshmërisht edhe me qëndrimin apo me tagrin që ka Këshilli i Ministrave për këtë problem. Në dijeninë time janë

rreth 247 anëtarë bordesh në Shqipëri, pa futur këshillat bashkiakë. Prandaj, unë mendoj se duke qenë materiali i paplotë dhe argumentet që sollën kolegët që Ministria e Financave dhe institucionet e tjera, që menaxhojnë paratë publike, të sjellin informacion, ne ta marrim në konsideratë dhe t'ia lëmë kompetencë mandatit të ri, pasi është më e moralshme dhe më parimore, sepse kërkesa e parë e bordit të ri na vjen pikërisht për rritje pagash, ndërkohë që duhet të na sjellin një platformë më të plotë për funksionimin, për vizionin dhe për të gjitha detyrat që do të menaxhojë ky bord, që ne e kemi votuar edhe në parlamentin e Shqipërisë.

Së treti, Televizioni shqiptar subvencionohet nga buxheti i shtetit, por ka edhe të ardhurat e veta. Ne gjithmonë kemi pasur kërkesa për shumë financime, për të arritur të menaxhojë të gjitha problematikat që ka, por dhe të gjithë trashëgiminë problematike të mbartur, ashtu siç kanë sjellë edhe kërkesa për rritje page për punonjësit e Televizionit publik shqiptar. Prandaj le të marrim informacionin e plotë nga institucionet publike, kryesisht nga Ministria e Financave, dhe mendoj që mandatin tjetër Komisioni i ri për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik ta shqyrtojë këtë kërkesë.

Faleminderit!

**Ramazan Gjuzi** – Faleminderit, zoti Nasufi!

Fjala për ju, zoti Piciri.

**Erjon Piciri** – Faleminderit!

Nuk m'u përmend emri, por m'u sulmuan idetë dhe kjo është më e rëndë.

Nuk fola në mënyrë përcmuese për RTSH-në, por u sugjeroj të gjithë kolegëve të shohin se ku renditet puna e RTSH-së në lidhje me mediet shqiptare. Unë kam nxjerrë disa të dhëna dhe është diku te 2,8%.

Unë nuk u vërtitem kështu emrave, por zonja Kumbaro tha që mbulon territorin. Nuk lidhet me territorin, por me cilësinë dhe audiencën, me peshën që ka tek audienca kombëtare.

Kam nxjerr disa të dhëna, të cilat lidhen me faktin që është nga televizionet e fundit. Nuk e kam me çështjen e televizioneve, sepse në qoftë se u shtohet 100 euro disa njerëzve, nuk është ndonjë dramë e madhe kombëtare, por me faktin që ne paguajmë shumë për një cilësi të dobët qoftë të qeverisjes, qoftë të këtyre këshillave kombëtarë, qoftë dhe të një elite dhe të një lidhshipi të madh, që qeveris vendin, që nuk i meritojnë pagat me të cilat shpërblehen. Ky është thelbi i diskutimit tim, që nuk ka lidhje me 500 apo 600 euro që do të shtohen në tërësi në lidhje me Radiotelevizionin, por me faktin që ne paguajmë dhe çojmë dëm parane publike pikërisht për një lidhship të dobët, pa rezultate. Kjo nuk ka lidhje as me votën, as me të tjerat dhe as me lojëra fjalësh, por me faktin që nuk kemi cilësi produktesh në Radiotelevizion, në

qeverisjen e vendit dhe në çfarë të dëshironi! Shikojini se ku janë parametrat ndërkombëtarë të Shqipërisë në thuajse çdo fushë!

Faleminderit, kryetar!

**Ramazan Gjuzi** – Faleminderit, zoti Piciri!

**Musa Ulqini** – Me leje?

**Ramazan Gjuzi** – Po, zoti Ulqini.

**Musa Ulqini** – Faleminderit, zoti kryetar!

Jam i detyruar ta marr fjalën për herë të dytë, sepse dua të them dy gjëra, që besoj se janë të rëndësishme për RTSH-në.

E mbështes fuqimisht zonjën Kumbaro në atë që tha dhe dua t'i them parafolësit që ajo që ka lexuar është një *fake news*, i prodhuar, po i quaj OJQ, por nuk janë as OJQ, nga disa individë të sponsorizuar nga një media private, të cilin e kam dëgjuar edhe unë. Në mënyrë absolute, kur flasim për audiencën në Shqipëri ka një problem shumë të madh: nuk ka një institucion që të publikojë të dhëna të sakta, por unë dhe anëtarët e komisionit e dimë që një institucion shumë i rëndësishëm, siç është “Konrad Adenauer”, e dimë shumë mirë se cili është ky institucion, është i partisë së Merkelit, ka bërë një studim për këtë çështje dhe ka publikuar një dokument zyrtar, dhe në këtë studim, të bërë me paratë e parlamentit dhe qeverisë gjermane, thuhet: “RTSH-ja ka besueshmërinë më të lartë krahasuar me të gjitha televizionet publike në Ballkanin Perëndimor. RTSH-ja ka sot besueshmërinë më të lartë krahasuar me mediet private në Shqipëri. RTSH-ja duhet të punojë akoma më shumë që të rrisë audiencën e vet”.

Këto janë fakte dhe unë mendoj se asnjë e dhënë e medieve private, që luftojnë mediet publike në këtë vend, nuk mund të dalë para këtij pohimi, që është një dokument zyrtar. Kjo është e para dhe është shumë e rëndësishme.

E mbështes fuqimisht mënyrën se si zonja Kumbaro mbrojti të vërtetën, jo RTSH-në. Unë solla thjesht një fakt për të argumentuar atë që tha zonja Kumbaro.

E dyta, Këshilli Drejtues mund të mblidhet nga mëngjesi deri në darkë. Unë thjesht kërkova të zbatohet ligjin dhe të bëjë detyrën. Detyra është të zgjedhë zëvendëskryetarin e vet dhe të hapë sa më parë vakancën. Kjo është ligjore. Nuk ka lidhje nëse mblidhen paradite a pasdite, pra me orën. Kjo është ligjore dhe unë kërkova të zbatohet ligji.

E treta, zonja Kumbaro, unë kam takuar përfaqësues të institucioneve zyrtare dhe, në dijeninë time, edhe si anëtar i Komisionit të Integritetit, ndërkombëtarët, ata që monitorojnë mediet në Shqipëri, nuk di të na kenë kërkuar standarde që bien ndesh me standardet e BE-së, ku duam të shkojmë dhe me interesat e vendit tonë.

Shqetësimi im është në funksion dhe i shkon për shtat kësaj maxhorance, sepse ndërkombëtarët kërkojnë të zbatohet ligji dhe të zbatohen standardet që nuk bien ndesh me interesat tona, se ndryshe është pa kuptim. Më vjen shumë keq që jam i detyruar ta kundërshtoj atë që tha zonja Kumbaro për këtë çështje, por unë nuk mund të bëj gabime të tilla, jo se jam anëtar i Komisionit të Integritimit, por sepse kam një jetë të tërë që punoj këtu; kam punuar...

**Mirela Kumbaro** – Ndjesë, por kam vetëm një gjë, zoti Ulqini: thatë diçka që unë nuk e thashë!

**Musa Ulqini** – ...ju thatë që ne shikojmë interesat tona...

**Mirela Kumbaro** – Unë nuk e thashë kështu. Unë nuk thashë që çfarë kërkojnë ata, bie ndesh me çfarë bëjmë ne. Ju thatë diçka që unë nuk e thashë, më vjen keq!

**Musa Ulqini** – Zonja Kumbaro, ju thatë: “Ne shikojmë në fund interesat tona”...

**Mirela Kumbaro** – As këtë nuk e thashë, zoti Ulqini.

**Musa Ulqini** – Në qoftë se nuk e keni thënë kështu...

**Mirela Kumbaro** – Nuk e thashë, pra! Keni mundësi që, pasi të mbarojmë mbledhjen, ta ridëgjoni edhe një herë mbledhjen për të kuptuar që nuk e thashë.

**Musa Ulqini** – Dakord! Do të jetë shumë mirë në qoftë se nuk e keni thënë kështu dhe do të jetë shumë mirë po të kem gabuar unë.

**Ramazan Gjuzi** – Ju faleminderit, zoti Ulqini!

**Erion Piciri** – Zoti kryetar...

**Ramazan Gjuzi** – Po, zoti Piciri.

Shkurt, ju lutem!

**Erion Piciri** – Dakord.

Unë kam shumë të dhëna, por besoj shumë te një medie tërësisht e pavarur, jashtë politikës, që është Monitor.al.

Krahas shumë të tjerave, që mund të jenë spekulime, kjo medie bazohet në të dhëna reale për performancën e televizionit publik shqiptar. Në të dhënat e saj, Televizioni nuk qëndron në nivelet që ne pretendojmë ose që po diskutojmë këtu.

Nuk dua të hyj në një debat të madh.

Çështja është spekulimi me paratë publike. Stop! Nuk ecet më. Mund të ecë dhe 4 vjet, por që ne të godasim privatin dhe të shpërdorojmë paratë publike, nuk mund të ecë pafundësisht. Kemi një sektor të fryrë publik. Nuk do të ketë më.

**Ramazan Gjuzi** – Faleminderit, zoti Piciri!

**Ismet Beqiraj** – Zoti kryetar!

**Ramazan Gjuzi** – Po, zoti Beqiraj.

Nuk keni dalë me figurë, zoti Beqiraj.

**Ismet Beqiraj** – Ka një problem në rrjet.

Duhet ta pranojmë që kjo çështje është shumë sensitive.

Sinqerisht, duke dhënë dakordësi për mendimet e pjesës më të madhe të kolegëve, nuk jam në kundërshtim me kërkesën e çdo institucioni të zgjedhur, sidomos institucioneve, që zgjidhen nëpërmjet votës së deputetëve të Kuvendit.

Nuk kam kundërshtime për rritjen e pagave në tërësi, jo vetëm të drejtuesve të institucioneve, të anëtarëve të këshillave, por sidomos të personelit të këtyre institucioneve.

Ne jemi në fazën që Kuvendi i ri, i cili do të mandatohet në shtator, do të fillojë me diskutimin e projektbuxhetit kalendarik që vijon.

Zoti Bungo është drejtuesi i ri i Këshillit Drejtues dhe më ka bërë përshtypje në dëgjuesën e kaluar në komision, qasja tjetër për shpërblimet në institucionin, nëse do të ishte kryetar i Këshillit Drejtues të RTSH-së, ku donte të fuste konceptin e performancës. Mua, si deputet, do të më pëlqente që kërkesa e parë e tij të ishte për rritjen e pagave të personelit, të specialistëve.

**Ramazan Gjuzi** – Nuk bëhet fjalë për personelin, zoti Beqiraj, por për Bordin.

**Erion Piciri** – Kryetar, është çështje koncepti.

Po flet për njerëzit e thjeshtë, të cilët bëjnë punën atje, ndaj më lejeni të flasë zotin Beqiraj, sepse është ...

**Ismet Beqiraj** – Ju lutem, mos ndërhyjni!

Më lejoni të them mendimin tim!

Unë nuk po përjashtoj mendimet e tjera. Kemi mbledhje komisioni, zoti kryetar, dhe këtë po them.

Së pari, nëse do të kemi rezultat, nëse do të kemi punë dhe performancë, më pëlqeu ideja e kryetarit të Këshillit Drejtues, dhe nuk po e kritikoj, duhet t'i mëshojë deri në fund kësaj ideje, por jo të bëjë kërkesa të paargumentuara në këto momente. Do të vijë projektbuxheti dhe sigurisht, do t'i shikojmë.

Gjithashtu, edhe këtë që ka tagër Kuvendi, për të marrë vendim për rishikimin e pagave, por, së pari, për personelin, që jep produkt, për të gjithë artistët, gazetarët, shkrimtarët, njerëz që japin kontribute, që japin produkt. Ky është mendimi im.

**Ramazan Gjuzi** – Faleminderit, zoti Beqiraj!

Hedhim në votë propozimin e zotit Ulqini dhe të zonjës Bello.

Kush është dakord për t'i kërkuar RTSH-së studim më të thelluar dhe argumentim ligjor për shtesën që ata kërkojnë dhe Ministrisë së Financave për ta sqaruar? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Mbledhjen e deklaroj të mbyllur.

Faleminderit dhe ditën e mirë!

## **MBYLLET MBLEDHJA**